



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR

VLORË

NR.104 AKTI

DT.ARDHJES 29.01.2014

NR.104 VENDIMI

DT.VENDIMIT 04.06.2014

V E N D I M

"NË EMËR TË REPUBLIKËS"

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë me trup gjykues të përbërë prej:

GJYQTAR: LAURENT FUÇIA

Me pjesmarrjen e sekretares gjyqësore Nilda Thanasko, sot në Vlorë, më datë 04.06.2014, mori në shqyrtimin në seancë gjyqësore publike, çështjen penale me Nr.104 Akti, me palë:

KËRKUES:

[REDAKTUE] i biri [REDAKTUE] dhe [REDAKTUE], datëlindja 01.03.1982, lindur në Fier dhe banues në Tiranë, lagjia "5 Maji", përfaqesuar me prokurën e posaçme Nr.270 Rep., Nr.106/2 Kol., datë 21.01.2014, nga AIE [REDAKTUE] anëtar i Dhomës së Avokatisë Vlorë.(në mungesë në shpalljen e vendimit).

PJESMARRËSE:

Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, përfaqësuar nga Prokurori [REDAKTUE].(në mungesë në shpalljen e vendimit).

OBJEKTI:

Heqja e sekuestros së automjetit tip "Scania", kamion, me targa [REDAKTUE]

Gjykata, pasi administroi aktet e ndodhura në dosjen gjyqësore, e shqyrtoi çështjen në tërësi, dëgjoi diskutimet përfundimtare të palëve, të cilat kerkuan:

-**Pala kerkuese** [REDACTED] përmes mbrojtësit të tij, Av. [REDACTED]: "Pranimin e kërkesës sipas objektit të saj".

-**Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë, përfaqësuar nga prokurori** [REDACTED]: "E lëmë mënyrën e përfundimit të çështjes në çmimin e gjykatës".

VËREN:

A.Rrethanat e faktit.

1. Pala kerkuese, shtetasit [REDACTED], ka paraqitur përpara kësaj Gjykate kërkesën penale, me objektin dhe bazën ligjore të prezantuar në pjesën hyrëse të këtij vendimi.

2. Me anë të shkresës Nr.79/40 Prot., datë 24.12.2009, lëshuar nga Drejtoria e Policisë, Qarku Vlorë, Seksioni Kundër Trafiqeve, rezulton se, janë përcjellë pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlore, materialet procedurale në ngarkim të shtetasit [REDACTED] në lidhje me veprën penale të "Trafikimit të mjeteve motorrike", parashikuar nga neni 141/a i Kodit Penal.

3. Nga përbajtja e informacionit të referimit të veprës penale te prokurori, bashkangjitur shkresës së sipërcituar, datë 24.12.2009, ka rezultuar se, në bazë të njoftimit të realizuar nga ana e Portit Detar Vlorë dhe pas verifikimit të sistemit të Interpolit, është konstatuar se, automjeti tip "Scania" kamion, me ngjyrë jeshile të errët, me targa [REDACTED] me numër shasicë [REDACTED], figuronte i vjedhur në shtetin Hollandez.

4. Pas marrjes dijeni mbi veprën penale dhe autorët e dyshuar të saj, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë, ka urdhëruar në datën 25.12.2009, fillimin e procedimit penal Nr.79/40, për veprën penale të "Trafikimit të mjeteve motorrike", parashikuar nga neni 141/a i Kodit Penal.

5. Në kuadër të procedimit penal si më sipër, nga ana e organit procedues në fazën e hetimeve paraprake(*prokuroria dhe policia gjyqësore*), me qëllim hetimin e faktit penal dhe individualizimin e autorit të veprës penale, janë realizuar një sërë veprimesh hetimore dhe midis të tjera, në datën 24.12.2009, ora 14.30 është realizuar veprimi me iniciativë i policisë gjyqësore, konform parashikimit të

nenit 300/2 të K.Pr.Penale, ai i sekuestrimit të provës materiale, automjetit tip "Scania" kamion, me ngjyrë jeshile të errët, me targa [REDACTED], me numër shasic [REDACTED], në pronësi të subjektit tregtar, shoqërisë [REDACTED] sh.p.k, me administrator shtetasin [REDACTED].

6.Me anë të urdhërit të prokurorit të datës 25.01.2010 (*është ekzekutuar nga ana e shërbimeve të policisë gjyqësore në datën 29.01.2010*), është urdhëruar lënia në ruajtje e sendit të sekuestruar, shtetasit [REDACTED], me detyrimin për të mos kryer asnjë veprim disponimi mbi sendin.

7.Me anë të shkresës me lëndë "Kërkesë për ndihmë juridike drejtuar Aturoritetevë Gjyqësore Hollandeze" Nr.1326 Prot., datë 05.02.2010, ka rezultuar se, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë, përmes Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm dhe Ministrisë së Drejtësisë së Republikës së Shqipërisë, i ka paraqitur kërkesë për ndihmë juridike, Aturoritetevë Gjyqësore Hollandeze, me qëllim vënien në dispozicion të të dhënave përkatëse të cilat i korrespondojnë automjetin tip "Scania" kamion, me ngjyrë jeshile të errët, me targa [REDACTED], me numër shasic [REDACTED].

8.Referuar shkresës "Kthim përgjigje" datë 25.02.2010, lëshuar nga BKT-Dega Vlorë, drejtuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë, ka rezultuar se, shtetasit [REDACTED], ka kryer transfera në BKT, nga shoqëria [REDACTED] sh.p.k, për llogari të shoqërisë [REDACTED] [REDACTED] me seli në Hollandë, në datën 14.10.2009 për shumën 15.000 euro dhe në datë 07.12.2009 për shumën 2.000 euro. Shumat e mësipërme janë paguar në funksion të përbushjes së detyrimeve kontraktore, të lindura si rezultat i kontratës së blerjes datë 15.11.2009, lidhur midis shoqërisë [REDACTED] sh.p.k dhe shoqërisë [REDACTED] me seli në Hollandë.

9.Në datën 02.03.2010, me urdhër të prokurorit është vendosur lejimi i shtetasit [REDACTED], që të përdorë automjetin tip "Scania" kamion, me ngjyrë jeshile të errët, me targa BKN 837, me numër shasic [REDACTED].

10.Në kushtet kur, nga ana e Aturoritetevë Gjyqësore Hollandeze, nuk rezulton t'i jetë kthyer përgjigje këkresës për ndihmë juridike të realizuar nga ana e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë, si dhe në kushtet kur, nga ana e organit procedues ishin realizuar të gjitha veprimet hetimore të çmuara si të nevojshme, në funksion të procedimit penal Nr.1771 të vitit 2009, me vendimin e prokurorit të datës 21.04.2010, është vendosur pushimi i hetimeve paraprake në lidhje me procedimin penal si më sipër.

11.Në këto rrethana fakti, në datën 29.01.2014, nga ana e shtetasit [REDACTED] është paraqitur përpara kësaj gjykate

kërkesa penale me objekt "Hegjen e sekuestros së automjetit tip "Scania", kamion, me targa [REDACTED]

B.Liqji i aplikueshëm.

12.Neni 41 i Kushtetutes se Republikës se Shqipërisë, parashikon se: "1. E drejta e prones private eshte e garantuar.

2. Prona fitohet me dhurim, trashegim, me blerje dhe me çdo menyre tjeter klasike te parashikuar ne Kodin Civil."

13.Neni 1, Protokolli 1 i Konventes Europiane per te Drejtat e Njeriut, parashikon se: "Çdo person fizik ose juridik ka te drejte per respektimin e pasurise se tij. Askush nuk mund te privohet nga prona e tij, veçse per arsyet e dobise publike dhe ne kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e per gjithshme te se drejtes nderkombetare.".

14.Neni 187 i Kodit të Procedurës Penale parashikon se: "Prova materiale janë sendet që kanë shërbyer si mjete për realizimin e veprës penale ose mbi të cilat gjenden gjurmë apo që kanë qënë objekt i veprimeve të tē pandehurit, produktet e veprës penale dhe çdo lloj pašuri të tjetër, që lejohet të konfiskohet, sipas nenit 36 të Kodit Penal, si dhe çdo send tjetër që mund të ndihmojë për sqarimin e rrethanave të çështjes."

15.Neni 217 i Kodit të Procedurës Penale parashikon se: "1.Kur nuk është e nevojshme mbajtja e sekuestros për qëllime prove, sendet e sekuestruara i kthehen atij që i takojnë edhe para se të merret vendimi përfundimtar. Kur është e nevojshme, organi procedues urdhëron të sillen sendet e kthyera.

2.Gjkata mund të disponojë që kthimi i sendeve të mos bëhet kur, me kërkësen e prokurorit ose të paditësit civil, duhet të mbahet sekuestrimi për të siguruuar padinë civile.

3.Pasi vendimi merr formë të prerë, sendet e sekuestruara i kthehen atij që i takojnë, përvëç rasteve kur vendoset konfiskimi."

16.Neni 218/1 i Kodit të Procedurës Penale parashikon se: "1.Gjkata vendos për kthimin e sendeve të sekuestruara kur nuk ka dyshim për përkatësinë e tyre."

17.Neni 300/2 i Kodit të Procedurës Penale parashikon se: "2.Kur ka rrezik që gjurmët dhe sendet të ndryshojnë ose të humbasin dhe prokurori nuk mund të ndërhyjë urgjentisht, oficerët e policisë gjyqësore kryejnë veprimet hetimore të domosdoshme dhe, kur është rasti, sekuestrojnë provat materiale dhe sendet që lidhen me veprën penale."

18.Neni 328/1/dh i Kodit të Procedurës Penale parashikon se: "1.Në çdo fazë të procedimit, prokurori vendos pushimin e akuzës ose

çështjes kur:

dhjdel se i pandehuri nuk e ka kryer veprën ose nuk provohet që e ka kryer ai".

19.Neni 470/1 i Kodit të Procedurës Penale parashikon se: "1.Gjykata që ka dhënë vendimin është kompetente për shqyrtimin e kërkesave dhe pretendimeve që lidhen me ekzekutimin e tij".

20.Neni 471/1/4 i Kodit të Procedurës Penale parashikon se: "1.Gjykata procedon me kërkesën e prokurorit, të interesuarit ose të mbrojtësit.

4.Seanca zhvillohet me pjesmarrjen e detyrueshme të prokurorit dhe të mbrojtësve. I interesuari, kur e kërkon, dëgjohet personalisht ose me letërporosi."

21.Neni 480/1 i Kodit të Procedurës Penale parashikon se: "1.Në fazën e ekzekutimit, gjykata është kompetente të vendosë për shuarjen e veprës penale pas dënimit, për shuarjen e dënimit, për dënimet plotësuese, për konfiskimin ose kthimin e sendeve të sekuestruara, si dhe për çdo rast të parashikuar me ligj."

C.Vlerësimi i gjykatës.

Gjykata çmon se, nga ballafaqimi i fakteve objekt gjykimi, me provat e administruara, si dhe me dispozitat e ligjit procedural penal, rezulton se, kërkesa e paraqitur nga ana shtetasit [REDAKTUE] është e bazuar në ligj dhe në prova dhe si e tillë duhet pranuar.

22.Gjykata çmon se, nga interpretimi sistematik dhe literal i neneve 208 e vijues, 270 e vijues, 300 e vijues të K.Pr.Penale, arrihet në përfundimin se, instituti juridiko-procedural penal i sekuestrimit shfaqet në disa forma:

-së pari, sekuestrimi si mjet për kërkimin e provës, i cili parashikohet shprehimisht në nenet 208-220 të K.Pr.Penale, i cili merret me vendim ose të prokurorit ose të gjyqtari dhe ka si qëllim të sigurojë kërkimin, gjetjen dhe marrjen e provës materiale.

-së dyti, sekuestrimi si masë sigurimi pasuror, i cili parashikohet shprehimisht në nenet 270-276 të K.Pr.Penale (*sekuestro preventive dhe sekuestro konservative*), i cili merret gjithmonë me vendimin e gjykatës, pas kërkesës së prokurorit dhe ka si qëllim që, të parandalojë zgjatjen apo rëndimin e pasojave të veprës penale apo për të garantuar shpenzimet gjyqësore, dënimin me gjobë apo shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga vepra penale.

-së treti, sekuestrimi si veprim procedural me iniciativë i

policisë gjyqësore(neni 300 i K.Pr.Penale), i cili përfaqëson një përjashtim nga rregulli i përgjithshëm(neni 208 i K.Pr.Penale), i diktuar nga nevojat urgjente hetimore dhe ka si qëllim kërkimin dhe marrjen e provës, por në këtë rast realizohet nga një subjekt tjetër procedural penal, i ndryshëm nga gjykata dhe prokurori, që është policia gjyqësore.

23.Koncepti apo përkufizimi juridiko-procedural i sekuestrimit, nuk parashikohet në mënyrë tekstuale nga dispozitat e K.Pr.Penale, megjithatë doktrina e së drejtës procedurale penale, e ka përkufizuar atë, si një gjendje juridike "ngrirjeje" mbi provat materiale apo sendet që kanë shërbyer për kryerjen e veprës penale(objekti i sekuestrimit), e cila vjen ekskluzivisht si rezultat i vendimit të organit procedures(gjykata, prokurori, policia gjyqësore) dhe në prezencë të dyshimeve të arsyeshme se, objekti i sekuestrimit përfaqëson një produkt të veprës penale(provë materiale), duke synuar kështu kërkimin e provës që gjendet në të apo parandalimin e zgjatjes së pasojave të veprës penale apo garantimin e pagimit të dënimit penal me gjobë, shpenzimeve gjyqësore apo dëmit civil të ardhur si rezultat i veprës penale.

24.Nga ana tjetër, sekuestrimi i sendeve-provë materiale, përsaqëson edhe një kufizim të të drejtës themelore të pronësisë, e cila parashikohet dhe garantohet nga nen 41 i Kushtetutës dhe nen 1, Protokoli 1 i KEDNJ-së, kufizim i cili realizohet me ligj(K.Pr.Penale), në përpjestim të gjendjes që së ka diktuar atë(kërkimi i provës apo masa e sigurimit pasuror) dhe gjithmonë për realizimin e një interesit publik(ndjekjen penale ndaj autorëvë të veprave penale dhe "ngrirjen" e pasurisë apo sendeve që rrjedhin nga vepra penale), për pasoje e kalon me sukses testin e proporcionalitetit, të parashikuar nga nen 17/2 i Kushtetutës.

25.Gjykata çmon se, vendosja e sekuestros, qoftë si mjet për kërkimin e provës, qoftë si masë sigurimi pasuror, është gjithmonë në funksion dhe është e lidhur pazgjidhshmërisht (*condicio sine qua non*), me prezencën e një procedimi penal të filluar nga organi procedures për një vepër penale konkrete, nga e cila dyshohet se, mund të kenë rrjedhur sendet e sekuestruara, që do të thotë se, me interpretim në të kundërt (*ad contrario*), për sa kohë që, procedimi penal i nisur ka pushuar (*rasti kur sekuestro hiqet nga prokurori*) apo është dhënë vendimi përfundimtar i gjykatës (*rasti kur sekuestro hiqet nga gjykata*), sendet e sekuestruara, të cilat i përkasin një subjekti të së drejtës civile(person fizik, person juridik, shtetit) dhe qarkullimi civil i të cilave nuk është i ndaluar, *ipso lege*, ato i kthelen titullarit të së drejtës reale(pronësisë, posedimit, etj).

26.Nëse përkufizimin e mësipërm e aplikojmë në rastin konkret,

do të arrijmë në përfundimin se, sekuestrimi i vendosur ndaj automjetit tip "Scania", kamion, me targa BKN 837, në pronësi të kërkuesit Ervin Skënderaj(Sulaj), përfaqëson një veprim me iniciativë të policisë gjyqësore(procesverbali i sekuestrimit datë 24.12.2009), i realizuar në kushtet e urgjencës dhe i vlefteuar nga prokurori, mbi bazën e dyshimeve të arsyeshme se, ky send përfaqëson një produkt të veprës penale të "Trafikimit të mjeteve motorrike", parashikuar nga neni 141/a i Kodit Penal.

27.Vendosja e sekuestros mbi sendin objekt gjykimi është realizuar në funksion të një procedimi penal të nisur nga ana e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë, që do të thotë se, gjendja juridike e "ngrirjes" së sendit, do të zgjaste për aq kohë sa do të ndodheshim përparrë një procedimi penal dhe në eventualitetin e pushimit të tij nga ana e organit procedues, sendi i sekuestruar duhet t'i kthehej titullarit të tij konform parashikimit të nenit 217 të K.Pr.Penale.

28.Gjkata çmon se, nga interpretimi sistematik i neneve 217, 218, 300/2 dhe 328 të K.Pr.Penale, ligjvënësi ka parashikuar midis të tjerave edhe subjektin procedural penal, i cili ka attributin që të disponojë në lidhje me kthimin e sendit të sekuestruar, duke pëedorur si kriter fazën në të cilën ndodhet procedimi penal, në fazën e hetimeve paraprake është atribut i prokurorit, ndërsa në fazën e gjykimit apo ekzekutimit të vendimit penal të somrës së prerë, është atribut i gjykatës(neni 218 i K.Pr.Penale).

29.Ka rezultuar e provuar se, me vendimin e prokurorit të datës 21.04.2010, është vendosur pushimi i hetimeve paraprake në lidhje me procedimin penal Nr.1771, të vitit 2009 për veprën penale të "Trafikimit të mjeteve motorrike", parashikuar nga neni 141/a i Kodit Penal.

30.Në datën 29.01.2014, nga ana e shtetasit [REDACTED] është paraqitur përparrë kësaj gjykate kërkesa penale me objekt "Hegjen e sekuestros së automjetit tip "Scania", kamion, me targa [REDACTED]

31.Provat mbi bazën e së cilave, pala kërkuese e mbeshtet kërkesën e saj, janë:

-Shkresa Nr.79/40 Prot., datë 24.12.2009, lëshuar nga Drejtoria e Policisë, Qarku Vlorë, Seksioni Kundër Trafiqeve, me të cilën i janë përcjellë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlore, materialet procedurale në ngarkim të shtetasit [REDACTED] në lidhje me veprën penale të "Trafikimit të mjeteve motorrike", parashikuar nga neni 141/a i Kodit Penal.

-Urdhëri i prokurorit datë 25.12.2009 për fillimin e procedimit penal Nr.79/40, për veprën penale të "Trafikimit të mjeteve motorrike",

parashikuar nga nenii 141/a i Kodit Penal.

-Procesverbal i sekuestrimit tē provës materiale datë 24.12.2009, automjetit tip "Scania" kamion, me ngjyrë jeshile tē errët, me targa [REDACTED], me numër shasie [REDACTED], në pronësi tē subjektit tregtar, shoqërisë [REDACTED] sh.p.k, me administrator shtetasin [REDACTED]

-Urdhëri i prokurorit i datës 25.01.2010 (i cili është ekzekutuar nga ana e shërbimeve tē policisë gjyqësore në datën 29.01.2010), me tē cilin është urdhëruar lënia në ruajtje e sendit tē sekuestruar, shtetasit [REDACTED] me detyrimin për tē mos kryer asnje veprim disponimi mbi sendin.

-Shkresa me lëndë "Kërkësë për ndihmë juridike drejtuar Aturoriteteve Gjyqësore Hollandeze" Nr.1326 Prot., datë 05.02.2010, lëshuar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë.

-Shkresa "Kthim përgjigje" datë 25.02.2010, lëshuar nga BKT-Dega Vlorë, drejtuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

-Urdhëri i prokurorit datë 02.03.2010, me tē cilin është vendosur lejimi i shtetasit [REDACTED] që tē përdorë automjetin tip "Scania" kamion, me ngjyrë jeshile tē errët, me targa BKN 837, me numër shasie [REDACTED]

-Kontrata e blerjes datë 15.11.2009, lidhur midis shoqërisë [REDACTED] sh.p.k dhe shoqërisë [REDACTED] me seli në Hollandë.

-Vendimi i prokurorit i datës 21.04.2010 për pushimin e hetimeve paraprake në lidhje me procedimin penal Nr.1771 të vitit 2009.

32.Pala pjesmarrësë, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë, përfaqësuar nga prokurori [REDACTED], e la mënyrën e përfundimit tē çështjes në çmimin dhe vlerësimin e gjykatës.

33.Gjkata çmon se, duke ballafaquar analizën juridike tē faktave objekt gjykimi, tē realizuar si më sipër, në harmoni me provat e administruara në gjykim dhe me dispozitat respektive procedurale penale(nenet 208, 217, 218, 300/2, 328 dhe 480/1 të K.Pr.Penale), në rastin konkret duhet disponuar me pranimin e kërkësës së paraqitur nga shtetasit [REDACTED] për heqjen e sekuestros dhe kthimin e sendit tē sekuestruar, automjetit tip "Scania", kamion, me targa [REDACTED], në kushtet kur me vendimin e datës 24.04.2010 tē Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë, është vendosur pushimi i procedimit penal Nr.1771, të vitit 2009 për veprën penale të "Trafikimit tē mjeteve motorrike", parashikuar nga nenii 141/a i Kodit Penal.

34.Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, si ligji themeltar dhe akti normativ me fuqinë më të lartë juridike në një rend normativ, ka sankcionuar në nenin 41 të saj se, pronësia fitohet përmes dhurimit,

34. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, si ligji themeltar dhe akti normativ me fuqinë më të lartë juridike në një rend normativ, ka sanksionuar në nenin 41 të saj se, pronësia fitohet përmes dhurimit, trashëgimit, ose çdo forme tjetër klasike të parashikuar në Kodin Civil (*në rastin konkret shitja e sendit*), duke i dhënë një rang kushtetues mjaft të lartë të drejtës së pronësisë, por edhe duke parashikuar në të njëjtën kohë disa nga mënyrat klasike të fitimit të saj, apo e thënë ndryshe, disa nga faktet juridike, vërtetimi i të cilave passjell si pasojë krijimin e marrëdhënieς juridike të pronësisë.

35. Ka rezultuar e provuar përmes kontratës së blerjes, datë 15.11.2009, lidhur midis shoqërisë [REDAKTUE] sh.p.k dhe shoqërisë [REDAKTUE] me seli në Hollandë, si dhe shkresës "Kthim përgjigje" datë 25.02.2010, lëshuar nga BKT-Dega Vlorë, drejtuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë, fakti se, kërkuesi [REDAKTUE] është administrator i shoqërisë "Haver" sh.p.k, e cila është pronare e sendit të luajtshëm, automjetit tip "Scania" kamion, me ngjyrë jeshile të errët, me targa [REDAKTUE] me numër shasie [REDAKTUE].

36. Në këto rrethana, në kushtet kur, rezultuan të provuara faktet e rënies nga fuqia të shkakut, i cili ka shërbyer si bazë përvendosjen e sekuestros mbi sendin objekt gjykimi (*procedimi penal*), si dhe autorësia e titullarit të së drejtës reale mbi këtë send, dhe duke marrë në konsideratë lidhjen e pazgjidhshme midis procedimit penal të nisur dhe sekuestrimit të sendit, gjykata çmon se, referuar testit kushtetues të proporcionalitetit(neni 17/2 i Kushtetutës) si dhe të drejtës themelore të pronësisë(neni 41 i Kushtetutës), duhet vendosur heqja e sekuestros së vendosur në datë 24.12.2009, mbi automjetin tip "Scania" kamion, me ngjyrë jeshile të errët, me targa [REDAKTUE] me numër shasie [REDAKTUE] dhe kthimi i tij në favor të kërkuesit [REDAKTUE].

37. Për sa më sipër gjykata çmon se, kërkesa e paraqitur nga ana e shtetasit [REDAKTUE] është e bazuar në ligj dhe në prova dhe si e tillë duhet pranuar.

Gjykata, pasiu tërroq përvendim dhe si u kthye, bazuar në nenet 217, 218, 300/2, 379 e vijues, 470, 480 të K.Pr.Penale,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkësës.
2. Heqjen e sekuestros së vendosur me iniciativë nga ana e

oficerëve të policisë gjyqësore në datë 24.12.2009, në lidhje me sendin e luajtshëm, automjet tip "Scania", kamion, me targa [REDACTED], me ngjyrë jeshile të errët, me numër shasicë [REDACTED], në pronësi të kërkuesit [REDACTED]

[REDACTED] duke i njohur dhe garantuar këtij të fundit ushtrimin e qetë të tagrave të pronësisë (*posedim, gëzim dhe disponim*) mbi sendin e sipërcituar.

3. Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Vlorë brenda 10 ditëve, duke filluar ky afat nga e nesërmja e shpalljes së tij. Për palët në mungesë, ky afat fillon nga e nesërmja e shpalljes.

U shpall sot, në Vlorë, më datë 04.06.2014.

**SEKRETARE
NILDA THANASKO**



**GJYQTAR
LAURENT FUÇIA**



Shpenzimet gjyqësore:

1. Shpenzime kancelarie=1.000 lekë.

REC'D BY: [REDACTED]
MJAFT: [REDACTED]
më datë 19.06.2014
of [REDACTED]



Shpenzimet gjyqësore
Nilda Thanasko
[REDACTED]